

Vërtetohet se është njëjtë me dokumentin origjinal që ndodhet në Arkivën e Bashkisë Mallakastër.
Sp. Arkivës: Envis Malaj

dt. 22.02.2016.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 2016 Prot.

Datë 1/12/2016
OP/M/2016.

KONTRATE SIPERMARRJE

Implementimi i Sistemit të taksave dhe tarifave vendore për qytetarin dhe biznesin e Bashkisë Mallakastër.

Sot ne datën 09.11.2016 nënshkruhet kjo kontrate për realizimin e objektit "Implementimi i Sistemit të taksave dhe tarifave vendore për qytetarin dhe biznesin e Bashkisë Mallakastër".

ndermjet paleve :

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Mallakastër, përfaqësuar nga Agron KAPLLANAJ, Kryetar, me adresë Ballsh Mallakastër, që me poshte do të quhet "Autoriteti Kontraktor"

dhe

Bashkimit të operatorëve ekonomikë: me Kontraten e bashkepunimit , Nr. 5852 rep nr. 1183 kol, date 12.10.2016

Infosoft Systems Shpk, themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) J61820021C, dhe adresë respektivisht Rruga "Murat Toptani", Gjergji Center, Tiranë, të përfaqësuar në këtë Kontratë nga Kryetari i Bordit Drejtues **Z. Grigor JOTI, përfaqësues i bashkimit të operatoreve me prokuren e posacem nr. 5853 rep, nr 1184 kol, date 12.10.2016.**

Infosoft Business Solutions Shpk, themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) L02214022G, dhe adresë respektivisht Rruga "Murat Toptani", Gjergji Center, Tiranë, të përfaqësuar në këtë Kontratë nga Administratori i Përgjithshëm **Z. Armand SHARA;**

që më poshtë do të quhen "Kontraktuesi", nga ana tjetër.

Baza Ligjore: Kontrata hartohet ne baze te dispozitave ligjore te parashikuara ne nenin 659,772 e vijues te kodit Civile, si dhe ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar si dhe VKM nr. 914 date 29.12.2014, "*Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik*"

Palet bien dakort dhe deklarojne nepermjet perfaqesuesve te tyre cilesuar me larte ne kontrate, se me vullnetin e tyre te lire e te plote lidhin kontraten ne kushtet qe vijojne:

Objekti i kesaj kontrate eshte: "Implementimi i Sistemit te taksave dhe tarifave vendore per qytetarin dhe biznesin e Bashkise Mallakaster".

Vlera e kontrates eshte: 7.804.220 (shtate milion e teteqind e katër mijë e dyqind e njëzetë) lekë pa TVSH ose 9.365.064 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e katër) lek me TVSH.

Afati i kryerjes se punimeve: 06 muaj implementimi i sistemit dhe 36 muaj mirembajtja e sistemit, duke filluar nga data e nenshkrimit te kontrates.

Pagesa Paraprake: Sic parashikohet ne kushtet e vecanta bshkelidhur kesaj kontrate.

Sigurimi kontrates: ne vleren 936.506,4 (nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë presje katër) lekë.


Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës, së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime





- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.


Neni 4 Praktikrat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.





5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuar ne përgjithsi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashte kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.





Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 9 Specifikime dhe Skicime

- 9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatiti të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.
- 9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjënjese përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 10 Lejet dhe Liçensat

- 10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.
- 11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.
- 11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.





Neni 12 Vendndodhja

- 12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.
- 12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Neni 14 Çmimi i Kontratës

- 14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 14.2 Çmimi total i kontratës është 7.804.220 (shtatë milion e tetëqind e katër mijë e dyqind e njëzetë) lekë pa TVSH ose 9.365.064 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e katër) lek me TVSH.

Neni 15 Afatet e Pagesës

- 15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 15.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës



16.1 Dëmet e llogaritura, të shikaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.

16.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

17.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 18 Forca Madhore

18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

18.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

19.2 Afati i ekzekutimit të kontratës është 6 muaj implementim dhe 36 muaj mirëmbajtje, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

19.3 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.



19.4 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shumën e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

19.5 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

19.6 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës..
- Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës...

Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet

21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 22 Ndryshimi i Porosisë

22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.



Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim

23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 26 Nënkontrata

26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

26.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.



26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të jape me nensipermarrje.

26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

Neni 27 Transferimi i të Drejtave

31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 28 Sigurimi i Kontrates

28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar.

28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 29 Baza Ligjore

29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 31 Përfaqësimi i Palëve

31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.



31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 32 Lajmërimet

32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 33 Llogaritja e Afateve

33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.



A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke.

KUSHTET E VEÇANTA

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1 Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është **Bashkia Mallakastër**.
- 1.2 Kontraktuesi është bashkimi i shoqërive **Infosoft Systems shpk dhe Infosoft Business Solutions shpk**.

Neni 2 Sigurimi i kontratës

- 2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej 936.506,4 (nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë presje katër) lek duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: Referuar Nenit 28 te KPK.

Neni 3 Fillimi i Kontratës

- 3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë më _____. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan kontratën.

Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve

- 4.1 Shërbimet do të kryhen në zyrat e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mallakastër.
- 4.2 Personat e autorizuar për ndjekjen e Kontratës
- Për "Autoritetin Kontraktor"
 - a) **Elvis Cirko**, cel: 0694093600
 - b) _____, tel _____ me adrese e-mail: _____
 - Për bashkimin e operatorëve **Infosoft Systems Shpk dhe Infosoft Business Solutions Shpk**
 - a) **Jonida Osmanlliu**, tel: +355 692917031, email: josmanlliu@infosoftgroup.com.al
 - b) **Sokol Refugjati**, tel: +355 0682093024, email: srefugjati@infosoftgroup.com.al



Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

Autoriteti duhet ti sigurojë Kontraktuesit të gjitha kushtet, informacionet dhe resorset e veta pa limit, persa kohe janë të nevojshme për zbatimin e kontratës.

Neni 6 Kërkesat e Raportimit

6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas kërkesave të mëposhtme:
Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe në origjinal dhe në 2 kopje.

6.2 **Raporti Fillestar**, prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet pas 3 javë, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhetimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar.

6.3 **Drafti i raportit perfundimtar**, numri i faqeve maksimale 12 (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para perfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.

6.4 **Raporti final**, me të njëjtat specifika si drafti i raportit perfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palet në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit perfundimtar është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin perfundimtar. Raporti perfundimtar duhet të sigurohet së bashku me fakturën përkatëse.

Neni 7 Siguricioni i Përgjegjësisë Profesionale

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguricionin e përgjegjësisë profesionale.

Neni 8 Kushtet e Pagesës

8.1 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:

- Pagesa për furnizimin e produkteve dhe licencave, që do të lëvrohen sipas grafikut të ekzekutimit dhe Formularit të cmimit (Zerat 1, 2 & 4), do të realizohet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të produkteve apo licencave, të shoqëruara me fakturën tatimore të shitjes përkatëse referuar çmimit të përcaktuar në Formularin e Ofertës.
- Pagesa për kryerjen e shërbimit të implementimit dhe trajnimin, që do të lëvrohen sipas grafikut të ekzekutimit dhe Formularit të cmimit (Zerat 3 & 5), do të realizohet brenda 30



ditëve nga data e dorëzimit te çdo fature, referuar çmimit të përcaktuar në Formularin e Ofertës.

Pagesa për shërbimet (Zeri 6 tek Formulari i çmimit) do të bëhet brenda 30 ditësh pas dorëzimit të çdo fature sipas ndarjes së zërave përkatës të detajuar në Aneksin 1 pjesë integrale të kësaj kontrate.

8.2 Monedha e pagesës do të jetë lek.

8.3 Të dhënat e llogarisë së Kontraktorit:

Banka: Intesa San Paolo Bank

Nr. llogarie: 20029035302

IBAN: AL 022081100800000 20029035302

8.4 Në rast se Qeveria Shqiptare vendos të mos miratojë fondin vjetor lidhur me shërbimin e mirëmbajtjes kontrata do të ndërpritet pa kosto për palët. Njoftimi respektiv do t'i komunikohet Ofruesit të Shërbimit të paktën 30 ditë përpara.

Neni 9 Pagesa Paraprake

9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda _____ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme.

Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës

10.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

Pas përfundimit të implementimit (6 muaj), vlera e sigurimit do të zbritet me 25% të vlerës totale të sigurimit. Pas përfundimit të çdo viti kalendarik të mirëmbajtjes vlera e sigurimit do të zbritet gradualisht me 25%, në përfundim të kohëzgjatjes së mirëmbajtjes, Autoriteti do të çlirojë edhe 25% e garancisë të mbetur për vitin e fundit.

Neni 11 Të Ndryshme

46.1 Kjo Kontrate do të hyje në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe mund të ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim nga të dy Palët.

46.2 Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.



46.3 Kjo Kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje, ku 3 (tre) kopje janë për Autoritetin Kontraktor dhe nga 1 (një) kopje për Kontraktuesit. Çdo kopje ka të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtën vlerë ligjore.

46.4 Kjo kontratë përbëhet nga Kushtet e Përgjithshme, Kushtet e Vecanta dhe Aneksi 1 pjesë integrale e kontratës. Gjithashtu kësaj Kontrate i bashkëngjitet Formulari i çmimit, Propozimi Teknik si dhe Shërbimet dhe Grafiku i ekzekutimit, paraqitur në ofertën fituese të cilat janë pjesë integrale e kësaj kontrate.

Autoriteti Kontraktor

Kontraktuesi

Bashkia Mallakastër


Infosoft Systems Shpk



Agron KAPLLANAJ



Infosoft Business Solutions Shpk



Armand SHARA

Aneksi 1
Detajimi i shërbimeve të mirëmbajtjes

Nr.	Pershkrimi	Sasia	Cmim Njesi ALL – pa TVSH	Cmimi Total ALL - pa TVSH
1.	Enhancement Plan per 36 muaj	1	3,161,721.00	3,161,721.00
	Sherbim periodik per funksionimin e			
1.1	vazhdueshëm të çdo licence			
	përdoruesi			
1.2	Sherbime nga portal i Microsoft			
1.3	Sherbim Upgrade të licencave			
1.4	Sherbime per zgjidhjen e çështjeve			
	teknike nga vete vendori Microsoft			
1.5	Sherbime mbi mundësinë për shtimin			
	e licencave të reja në vijim			
2.	Mirembajtje e sistemit ne vit	3	126,666.00	379,998.00
2.1	Sherbim on site			
2.2	Sherbim remote			
2.3	Pershtatje sipas ndryshimeve te			
	Legjislacionit			
2.4	Kontrolle periodike dhe raportim			
Total Leke – (pa TVSH)				3,541,719.00
TVSH – (20 %)				708,343.80
Total Leke – (me TVSH)				4,250,062.80

Ndarja Teknike e Mirembajtjes

1. GARANCI 3-VJECARE E SISTEMIT NGA PRODHUESI

Nga prodhuesi do te sigurohet garancia dhe mirëmbajtja e licencave të sistemit duke mundësuar *Enhancement Plan* per 36 muaj pas implementimit, i cili do te permbaje pikat e meposhteme. Garancia ofrohet nga vete furnitori Microsoft.



Blerja e Garancise realizohet qe ne momentin e blerjes se licencave te perdoruesit dhe do te jete aktive per 3 vjet.

BASHKIA MALLAKASTER

- 1.1 Sherbim periodik per funksionimin e vazhdueshëm të çdo licence përdoruesi; Microsoft do te siguroje gjate gjithë periudhes se garancise, vazhdueshmerine e funksionimit te licencave duke mos lejuar nderprerje te funksionimit te licencave dhe perorimin e sistemit.
- 1.2 Sherbime nga portal i Microsoft për informacion të detajuar mbi sistemin; Ne cdo momentet do te ofrohet mundesia per konsultimin me materialet online te Microsoft per ceshtjet dhe paqartesite qe mund te kene.
- 1.3 Sherbim Upgrade të licencave në rast të kalimit në një version tjetër të Dynamics NAV; Microsoft ne kuader te garancise do te ofroje mundusine per upgrade ne versionet me te reja te sistemit.
- 1.4 Sherbime per zgjidhjen e çështjeve teknike nga vete vendori Microsoft; Microsoft do te ofroje sherbim teknik per ceshtjet qe mund te hap Bashkia Mallakaster ne portal. Vete institucionit do ti ofrohet mundesia per nje llogari ne portalin e Microsoft me ane te te cilit mund te hap ceshtje teknike per tu zgjidhur nga Microsoft.
- 1.5 Sherbime mbi mundësine për shtimin e licencave të reja në vijim.

2. MIREMBAJTJE E SISTEMIT

Në kuadër të kësaj kontrate, Bashkimi i Operatoreve do të ofrojë shërbimet e listuara më poshtë për një periudhë 3-vjeçare, pas marrjes në dorëzim të sistemit.

2.1 Sherbim on site

Fillimi i diagnostikimeve on site/ on line dhe mbështetje për "debugging" brenda ditës së punës nga njoftimi i Autoritetit Kontraktor dhe përfundim të veprimeve korrigjuese brenda 24-48 orëve nga ky njoftim.

- Emergjenca për thirrje, shërbim vizitash në vend (on site) brenda dites së punës nga marrja e kërkesës së Autoritetit Kontraktor.
- Shërbim on site/ on line "për thirrje" për personalizimin e paketës së programit, e vlefshme brenda ditës pasardhëse të punës.

Asistencë për personelin IT për:



- o Analizë të të dhënave;
- o Gjenerim të raporteve të performancës.

MALLAKASTER

2.2 Sherbim remote


- Helpdesk të jetë aktiv 8 orë nga e Hëna në të Premten (08:30 – 16:30).
- Korrigjimi i gabimeve të funksionaliteteve.
- Mirëmbajtje të Bazës së të Dhënave.
- Ri-instalimi i sistemit me të gjithë komponentët e tij.

2.3 Pershtatje sipas ndryshimeve te Legjislacionit

- Çdo ndryshim i kryer si pasojë e ndryshimeve ligjore financiare dhe fiskale, duhet të kryhet me prioritet brenda një afati të tillë që nuk do të sjellë pengesë në realizimin e detyrave të Degës së Taksave, të cilat mbështeten mbi këtë sistem.
- Kompania do të jetë disponibël për ndryshimet në raportet përkatëse sipas kërkesës së bërë nga Bashkia Mallakaster, si për ato ekzistuese dhe për raporte të reja në kuadër të përmirësimit të punës në sektorin financiar.

2.4 Kontrolle periodike dhe raportim

- Kompania do te ndermarre, ne menyre periodike nje here ne jave, Sherbime te Mirembajtjes Parandaluese per te gjitha sistemet e listuara ne tabelen e Inventarit te Sistemit.
- Përgatitje të raporteve 3-mujore të detajuara, lidhur me punën e kryer nga kompania.
- Konfigurimi i klientëve dhe përdoruesve të rinj apo i atyre ekzistues në Bashkinë Mallakaster.



Handwritten signature